



RITE DHE AKTUALITETI

KOORDINATORË TË PROJEKTIT:

Zanita Halimi
Faton Maliqi
Simon Berisha

EKSPERTË PROFESIONAL DHE AUTORË TË TEKSTEVE:

Prof.dr Drita Halimi- Statovci
Prof.dr Ukë Xhemaj

PËRKTHIMI NË GJUHËN ANGLEZE:

Lumnije Kadriu

DIZAJNI:

Gent Salaj

Dhjetor 2011



RITI I VERZES



RITI I SHENGJERGJIT



RITI I THIRRJES SË SHIUT

PARATHËNIE

Shpeshherë na ndodh që në raste të caktuara të bëjmë ndonjë veprim, qoftë kjo si zakon, ose thjesht si praktikë të veçantë, pa e ditur mirë domethënien e tyre, e aq më pak historikun dhe lidhjen e tyre me të kaluarën. Një ndër rastet e veçanta të mbushura me praktika janë ritet e motmotit, që përbëjnë pjesë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore. Si dukuri kulturore ritet përbajnë veprime e praktika shoqërore nga më të ndryshme, ku secila ka domethënie e qëllimin e vet të veprimit dhe të arritjes së efektit në të mirë të njeriut.

Departamenti i Etnologjisë dhe Antropologjisë Kulturore në bashkëpunim me Organizatën e Etnologëve të Rinjë dhe me përkrahjen e Organizatës Trashëgimia Kulturore pa kufinjë ka realizuar projektin Rite dhe Aktualiteti, që ka për qëllim, hulumtimin, dokumentimin dhe prezantimin e riteve të motmotit . Studentët e Departamentit të Etnologjisë dhe Antropologjisë Kulturore kanë patur rastin, që përveç njohurive teorike, t'i hulumtojnë dhe t'i përcjellin drejtpërdrejtë në terren tri rite: Ritin e Verzës, Ritin e Shëngjergjit dhe Ritin e Thirrjes së Shiut.

Gjatë punës në terren janë dhënë shpjegime për domethënien e çdo veprimi a praktike shoqërore, të bërë gjatë procesit të riteve, pastaj ka patur xhirime dhe transmetime në televizionet qëndrore. Xhirimi i këtyre rritualeve do t'i ndihmojë jo vetëm generatave të ardhshme për ta njohur më mirë të kaluarën, për ta mësuar rëndësinë e rritualeve dhe të pasurisë trashëgimore të kulturës shpirtërore e materiale, por do të shërbej si material studimi për studiues të ndryshëm dhe jo vetëm të Etnologjisë dhe Antropologjisë kulturore.

Gjatë terrenit janë bërë fotografi të shumta nga vetë studentët e Departamentit të Etnologjisë dhe Antropologjisë Kulturore, disa prej tyre, prezantohen në këtë Katalog, me tekste e që ofrojnë shpjegimin e tyre përkatës. Në këtë Katalog nepërmjet shkrimeve të shkurtëra të Profesorëve të Departamenti të Etnologjisë dhe Antropologjisë Kulturore, respektivisht të Prof.dr Ukë Xhemaj me temën Ritet e Motmotit, dhe të Prof.dr Drita Halimi Statovci, me temën Veshja në funksion të riteve, lexuesit do të kenë rastin të informohen më tepër për rëndësinë e këtyre riteve si pjesë e trashëgimisë kulturore, si dhe për mbijetesën e elementeve ritual deri në kohën e sotme.

Bashkëpunimi përherë bënë punë më të mirë dhe jep realizime përmbytësore.

Në këtë rast , falemnderim i veçantë i shkon Organizatës Trashëgimia Kulturore pa Kufinjë, për përkrahjen e dhënë për këtë projekt, profesorëve dhe studentëve të Departamentit të Etnologjisë dhe Antropologjisë Kulturore, Organizatës së Etnologëve të rinj, banorëve të fshatit Bresanë të Opojës, të fshatrave Mazrekaj dhe Romajë të Hasit, për gatishmërinë dhe çiltërinë e tyre ndaj hulumtimeve tona, dhe posaçërisht për mikrpritjen e tyre shumë të ngrohtë. Veçmas falenderojmë televizionet RTV21 dhe KTV për kontributin e tyre dhënë në xhirimin e riteve dhe të hulumtimeve të drejtpërdrejta në terren, si dhe për emetimin e emisioneve për këto aktivitete.

Ky Katalog ndihmon në shpëtimin e së kaluarës, në mënyrë që ti shërbejë të tashmës dhe të ardhmes.

Ritet e motmotit dhe aktualiteti

Ritet e motmotit në kulturën shqiptare paraqesin një thesar vlerash, që në përbajtjen e tyre ruajnë të mbijetuara shumë besime, bestytini, veprime magjike me karakter homeopatik spastrues apo të plleshmërisë - gjithnjë me synim në mbarvajtje dhe shërbim të individit, grupit apo rrethit më të gjerë shoqëror. Ritet janë një ngjizje e mënyrës së jetës njerëzore në mjedisin natyror duke pasqyruar denjësisht lidhjet : njëri – natyrë. Këto raporte shprehin kuptimesinë e jetës si një shfaqje veprimesh kushtimisht të ndërlydhura me fenomene dhe dukuri natyrore – drejtpërsëdrejti si një mundësi e të jetuarit në mjedis gjeografik. Këto vlera kulturore të bashkërenditura në ceremonitë rituale të riteve të motmotit, në traditën kulturore shqiptare e sidomos në krahina më të thella etnografike siç janë Opoja e Hasi, i hasim të shtresëzuara. Të shpaluarit e atyre shtresëzave na përvihojnë në e sotmja deri në një lashtësi të muget historike, përkatësisht deri tek format e hershme të organizimit të jetës, besimeve, dokeve, zakoneve, mënyrës së banimit, veshjes, veglave e mjeteve të punës, etj.

Vlerë e veçantë kulturore e këtyre riteve është masoviteti i pelegrinëve në ceremoni rituale, struktura sociale, gjinore e moshatare e pelegrinëve, përkushtimi kultik, aplikimi i kalendarit vjetor të punës i mbështetur në eklipsat diellore, besimi i mbijetuar në fenomene e dukuri natyrore, përvijsimi i tyre deri në aktualitet.

Dita e verzës në Opojë

Dita e Verzës në Opojë është njëri ndër ritet e motmotit që i bëhet një përkushtim i veçantë. E feston e gjithë popullata e Opojës, natën e 13 marsit deri në të lindur të diellit ditën e 14 marsit. Është e lidhur me ekuinoksin pranveror, sadita-nata, sipas kalendarit popullor.

Riti është i përbushur me shumë elemente të karakterit magjik me synim spastrimi, plleshmërie, shëndeti, kushtuar individit, familjes, grupit, farefisit, fshatit. Për nga masoviteti ka karakter pelegrinazhesh. Ceremoniali fillon nga familjet ndërkaq përfundon në vende të ngritura të lagjes, si vendtakimi i pelegrinëve të lagjes. Vendi ku zhvillohet ceremonia tradicionale ka karakter kultik dhe është i njëjti prej vitesh. Ky rit, në fshatin Bresanë organizohet në kodrinat e mbifshatit, në të ngritura mali, ku secila lagje ndezin zjarre rreth të cilit zhvillohet rituali. Kështu atë natë e gjithë Opoja shëndërritë nga flakët e zjarreve, gjithnjë në garë për zjarrin më të madh se lagja tjetër, se fshati tjetër – simbolikë kjo e rritës dhe mbarësisë së familjes, lagjes e fshatit.

Si zhvillohet ceremonia:

Parapregaditja për rit fillon ditë më parë. Të rinjë e të reja – djemë e vajza – dalin fushës për të mbledhur dëllinja, degëza çetinas, tallë misri, kashtë drithërash e kohëve të fundit dhe goma makinash, të cilat i renditin rreth një druri të ngulitur në kodrinën mbi lagje të vetë, të fshatit, të cilat do bëjnë zjarrin ritual kur të ndizet nga pelegrinët në orët e para të ditës së re të datës 13 në të 14 të Marsit. Ndërkaq, natën e festës, vajzat mbledhin vezë, i dekorojnë ato me motive të ndryshme dhe i ziejnë dhe secila në shportën e vet i marrin në ceremoni, me të cilat bëjnë veprime të karakterit magjiko-ritual kushtuar rritës, shëndetit, spastrimit, me formula magjike që shprehin ato mbështetur për lisi. Festa ka karakter agraro-blegtoral – e dedikuar kryesisht familjes, mirëqenjes së saj në shëndet, në të mira e rendimente në bujqësi, blegtori dhe shtim njerëzor. Zjarr paraqet qenësinë e ritualit. Ka karakter spastrues dhe të plleshmërisë. Është i ndërlydhur me kultin e Diellit si një pjesë e panteonit hyjnor që i kushtohet, në traditën e lashtë, me lutje, pikërisht në këtë të hyrë të stinës së verës kur dhe fillojnë punët në bujqësi.

Plleshmëria synon të arrihet, përmes simbolikës së flakës së zjarrit – dritës, që paraqet Diellin, ndriçimin dhe ngrohtësinë e tij, si një kusht i zhvillimit të bimësisë dhe jetës. Ndërkaq, spastrimi i pelegrinëve nga mekatet eventuale, demonët negative, spastrimi i fushës, spastrimi i objekteve të banimit të njerëzve, kafshëve, objekteve ekonomike, drithnikëve, koshave të misrit, flantikëve, etj, bëhej përmes kapercimit – tri herë - të zjarrit kur ai është në shuarje e sipër, por dhe me urëza zjarri në dorë të pelegrinëve duke ngacmuar ato për të lëshuar shkëndijë dhe duke u futur në objekte e shetituri fushës ku bëhen të mbjella. Pelegrinët, në kostume festive, këtë ceremonial e madhështojnë me këngë- të percjella nga vajzat me def- e vallezime rreth zjarri me orë të tëra, duke shprehur gëzimin e hyrjes në stinën e verës së vogël – Verzës. Ceremoniali, vazhdon tutje në orët e hershme të agimit, para lindjes së diellit, me larjen ritual të fytyrës dhe flokëve nga vajzat e lagjeve të fshatit në rrjedhjen e lumit mbi fshat. Simbolikë për arritjen e shëndetit, spastrimin nga të këqijat, që i dedikohen fuqisë magjike të ujit të rrjedhshëm. Ceremoniali vazhdon, gjithnjë para lindjes së Diellit me ndezjen e zjarreve të dyta, tanimë nëpër lagje të fshatit dhe më në fund me vizitat e pelegrinëve nga dera në derë - nga shtëpia në shtëpi – ku mbledhin dhurime mielli, gjalpi, djathi, vezesh, etj. nga zonjat e shtëpive, nga të cilat përgatitet Dreka rituale kushtuar kësaj feste, që njëherit paraqet dhe përfundimin e ceremonisë.

Riti i Shëngjergjit në Has

Është festë tradicionale popullore, e cila kremtohet me 6 Maj dhe konsiderohet, kudo ndër Shqiptarë dhe në Has, festë e kryemotit. Duke qenë e tillë ka ruajt shumë nga gjurmët e lashta që lidhen me natyrën dhe kalendarin e punës, kalendarin e jetës. Ka karakter agraro -blegtoral. Ndërlydhet me ekliptiken diellore të solsticeve, përkatësisht ndërrimin e stinëve – fillimin e verës e shoqëruar me punët në bujqësi dhe blegtori.

Riti i shiut në Has

Edhe kjo festë, sikurse dhe Verza në Opojë, realizohet nga pelegrinë në vende të caktuara kultike fshatrash. Manifestimi zhvillohet rreth zjarreve të ndezura në orët e hershme pa aguar dita, menjëherë në orët e para të ditës së re të 6 majit. Tani, në këtë festë, pelegrinët, moshë e gjini të ndryshme, por të dominuar nga të rinjtë, dalin duke ju rënë borozakëve, të punuar ditë para, nga lëvorja e frashërit apo e shelgjes, me sa fuqi kanë - duke krijuar kështu një oshëtimë të zërit trumpetues i cili shpërndahet në hapësirë, si një paralajmërim i një aktiviteti gjithëpopullor kushtuar kësaj feste, gjithsesi pagane e tani e mveshur me mbishtëza krishtere e islame. Ceremoniali zhvillohet rreth zjarreve.

E karakterizon rënja e burive – borozakëve me rrotullime rreth zjarri, kapërcime të zjarrit dhe shpërndarje flakadajve në fushë e mjedise fshati.

Bimësia e mbledhur natën e Shëngjergjit, vendosja e saj nëpër objekte banimi, objekte ekonomike, vendosja e saj në ujë me të cilin bëhet spërkatja dhe larja e fëmijëve para lindjes së diellit, ka synim spastrimi dhe plleshmërie.

Edhe ushqimi ritual për bagëti, me barishte, kungull të egër, bar-gjaku, shëvar t'butë, hudër t'egër, bar bodërnice, bar shëngjergji, etj, të grira e të përziera me miell nga magjësia dhe të kriposura, ju jipen bagëtisë paralindjes së diellit, përkatësisht, para lëshuarjes në kullosë. E gjithë kjo me synim mbrojtje nga sëmundjet, nga demonet negative, për mbarsë, shtim dhe plleshmëri. Në këtë kontest behet dhe flijimi i një qengji në derë të vathës, gjaku i së cilit futet në tokë me rastin e therjes.

Riti i ndjelljes(thirrjes) së shiut, në Has, sikundër në shumë treva tjera shqiptare, është një traditë popullore, tashmë e pa aplikuar. Brezat e moshuar janë dëshmi e aplikimit të saj në jetë, në stinën e verës, kur thatësia rrezikonte të mbjellat dhe kullotat, së këndeji jetën. Ceremonia rituale ka karakter homeopatiko-magjik. Realizohet përmes pelegrinëve, djemve e vajzave, por dhe shoqërimit nga disa të moshuar – simbolikë e transmetimit të traditës. Të gjithë të veshur me kostume solemne, përpos dordolecit, që është i veshur i tëri me gjethe e barishte të njoma si dhe i qaqosur në fytyrë (imitim i reve të shiut). Dordoleci, që duhet të jetë një vajzë jetime, preferohet të jetë e moshës fëminore (duke u rritur), është subjekti kryesor ndër pelegrinë që e rrethojnë dhe shoqërojnë gjatë gjithë rrugëtimit nëpër fshat, prej dere në derë, duke bërë lutje për të rënë shi. Me këtë rast nga secila portë oborri del nga një grua dhe dordolecin e spërkasin me ujë dhe pelegrinëve ju falin ca gjëra ushqimore: miell, bylmetë, vezë, me të cilat në fund të pelegrinimit përgatitet dreka ritualë për pelegrinë.

Dordoleci, është një lidhje ndërmjet fenomeneve natyrore dhe njerëzimit që, në të kaluarën e hershme paraqiste hyjninë e antropomorfizuar në shërbim të njerëzimit.

Brezi i moshuar, rrëfen edhe në përditshmëri, për realizimin e lutjeve që iu behëshin Zotit për rënjen e shiut dhe ai-Zoti iu falte shiun dhe kështu bëhej buka dhe bari dhe vazhdonte jeta.

Brezi i sotëm i kundron si rrëfeja të një jete dhe tradite që kanë kaluar prindërit e tyre.

Veshja në funksion të riteve

Literatura antropologjike ritet dhe ritualet i trajton si ngjarje ku përfshihen veprime të veçanta shoqërore, që zbatohen në kohë të caktuar, si fjala vjen në festa e data të shënuara, apo të dallueshme, me përfitim të të mirës për njeriun. Karakteristike për ritualet shfaqet shmangia, ose devijimi i sjelljeve të njeriut në përditëshmëri, në jetë të përcëditëshme. Shmangiet, si do të thuhej simbolikisht, nga normaliteti shfaqen me natyra të ndryshme dhe mundjenë të karakterit lëndor, ose thjesht të shfaqen si sjellje njerëzore e shoqërore. Poashtu duhet thënë se ritualet mund të jenë të natyrës sakrale ose sekulare, ose edhe të natyrës së kompozuar me të dyja këto segmente, dhe, së fundi thjesht të natyrës së religjionit të mirefilltë popullor-pagan. Veshja shfaqet me shumë rëndësi dhe zë një vend simbolik dhe komunikues në rastet ritualistike. Në këtë rrafsh do të njohim ca paraqitje të vogla, por që janë pjesë e një problematikë të gjërë. Këtë segment të kulturës materiale do ta njohim tani si dukuri të lidhur me ritet e ritualet, si pjesë e kulturës shpirtërore e shoqërore. Festa e Ditës së Verzës (kështu e quajnë në krahinën etnografike të Opojës, ndërsa gjetiu këtë festë e njohin si Dita e Verës), në Opojë, pikërisht në fshatin Bresanë ka arritur të ruhet e të festohet edhe në kohën më të re. Natyrisht se shumë çka, pra shumë elemente përbërëse të ritualit si tërësi, tani kanë marrë elemente dhe ngjyrimet e modernitetit, por e rëndësishme është se kjo festë ende shënon një datë të veçantë kalendarike, shënon gëzimin që me këtë rast po dilet në verë, shënon fenomene të natyrës, ngjalljen e natyrës dhe fillimin e vitit të ri. Në terren, pikërisht në fshatin Bresanë të Opojës, vërejtëm se kjo festë është mjaft e freskët në kujtesën e banorëve të kësaj ane, madje manifesto-het edhe me veprime e duke të veçanta festive.

Detyrë e imja sipas Projektit të Departamentit Etnologji-Antropologji kulturore, më obligon për analizat e veshjes, e cila mbahet në rastet festive dhe ritualistike. Të theksoj që në fillim, me këtë rast do të bëhet fjalë për veshjen e sotme, për atë që mbahet e preferohet sot, pa hyrë në detaje të veshjes së lashtësisë e të asaj të mirefilltë popullore, e as të teorieve e të kriterëve që i shtron antropologjia kulturore për veshje të tilla. Në Bresanë të Opojës, në vigjilen e festës, deri në orët e mbrëmjes (pra më 13.03.2011 kur ne shkuaam për hulumtime) vërejtëm një fenomen të ri, të kohës së re. Rinia shkollave, ajo e shkollave të mesme, por edhe të shkollave fillore kishin lansuar dhe stabilizuar një doku të re – shëtitje këmbë në rrugët e lagjeve të fshatit, por edhe shëtitje me vetura. Këtu duhej të tregohet se kush ka veturë më të mirë, dhe se kush ishte çifti më i mirë e më i pëlqyeshëm ndërmjet atyre që qarkullonin nga disa herë rrugëve të fshatit. Veshja me të cilën defilonte rinia ishte plotësisht e kohës së re, ajo evropiane pra, madje pa asnjë petk kostumor të veshjes popullore. E habitshme kjo për vrojtuesin studiues-antropolog, por si duket elementet e kulturës popullore shfaqen më të pëlqyeshme dhe më të preferueshme në vendbanimet urbane. Rinia e qendrave urbane konsideron se po mbanje diçka të traditës, diçka të vjetër dhe atraktive, atëherë je në hap me kohën, je „trendy“, je „cool“ dhe je modern, sakaq rinia e venbanimeve rurale, si duket, ende nuk e dialogon dhe as nuk e pranon këtë dukuri si trashëgimi dhe pasuri të veçantë. Fëmijet e vegjël, vajzat dhe djemtë mbanin veshjet më të mira që kishin, natyrisht të reja dhe moderne, por karakteristike e kësaj nate ishte se vajzat e vogla, pra vajzat e jo djemtë, secilia sosh, në dorë mbanin nga një çantë, apo trastë moderne, me nga disa vezë të ziera në to. Vezët ishin të „laruara“, pra të ngjyrosura me shumë ngjyra dhe me ornamente të ndryshme. Madje, dikush mbante në dorë një vezë të drunjte, të kamufluuar për mrekulli me shumë

ngjyra, dhe kështu me të ua thente vezët të tjerëve, ndërsa të tjerët nuk mund të kishin sukses në këtë veprim.

Vezët e ziera, traditë kjo e bartur brez pas brezi deri në kohën e sotme, simbolizonin jetën-nismën e jetës së re dhe rritjen në përgjithësi. Kishin zakon, që të veshur sa më mirë të defilojnë nëpër fshat dhe t'i cakronin vezët ndërmjet vete, por edhe për ndonjë lisi, duke thirrë tri herë: „tak-tak-tak, u befsha sa lisi gatë“. Pas përfundimit të ceremonialit, dhe pas shëtisë nëpër fshat duke mbledhë vezë, si dhe pas „garimit“ se kush ka fituar më shumë vezë, këto tani, secili fitues i çonte në shtëpi të vetë dhe atje i hanin bashkë me familjarët. Po ti referohemi Frejzerit, do të thoshim se këtu kemi të bëjmë me magji pozitive, të quajtur homeopatikë-imitative. Sipas kësaj magjie e mira sjell të mirën dhe e ngjashmja të ngjashmen, prandaj fëmijët janë të veshur me teshat më të mira që kanë, vajzat cakrojnë vezët ndërmjet vete dhe për lisa dhe gjithnjë këndojnë. Shpjegimi shkencor na thotë se kështu veprojnë për të përfituar nga vezët si nismë e jetës, pastaj nga kulti i bimësisë dhe veçmas i pemës, që mitologjia e konsideron si ndërmjetës për njerëzit dhe hyjnisë diellore. Edhe prania e zjarrit në këtë rit, përkatësisht ndezja e zjarreve sipër lagjeve në shpatije të fshatit, si dhe kapercimi i zjarreve, poashtu ka të bëjë me kultin e diellit dhe me purifikimin, pastrimin e trupit, por ndoshta me dhënie fuqi (zjarr e flakë) për diellin. Me këtë rast nuk mund të flitet për zgjedhjen e veshjeve, kostumeve të mira popullore, meqë ato nuk i vërejtëm askund. Ndoshta veshjet e mira munguan edhe për arsye se do të dëmtoheshin nga zjarret e mëdha e me flakë të lartë.

Per këtë shkrim është konsultuar literatura sa vijon: Dress and Identity, ed. By Mary E. Roach-Figgins, Joanne B. Eucher, Kim K.P. Johnson, New York, 1995; A. Gjergji, Veshjet shqiptare në Shekuj, ASHSH, Tiranë, 1988; Rr. Zoji, Gjurmëve të një kalendari primitiv në popullin tonë, Buletin i Institutit të Shkencave I, Tiranë, 1949; D. Halimi-Statovci, Veshjet shqiptare të Kosovës, IAP, Prishtinë, 2009; P. Bogatyrev, The Functions of Folk Costume in Moravian Slovakia, Mouton The Hague-Paris, 1971; M. Eliade, Rites and Symbols of Initiation, Woodstock, Connecticut, 1995; U. Xhemaj, Shtresime Kulturore, IAP, Prishtinë, 2005; D. Halimi-Statovci, Studime për ushqimin dhe ushqimi popullor shqiptar, GJAFE nr. 35, IAP, Prishtinë 2005; N. Papeka, Kulte, Rite, Magji në traditën orale, Botimet Toena, Tiranë, 1999.

Po të shikohet si tërësi ky ritual i lashtësisë, që sot praktikohet mjaft rrallë, fitohet përshtypja se në kohën e re kësaj feste të rëndësishme kalendarike, që është pjesë e një kalendari popullor shqiptar shumë të saktë e preciz, me emërtime të veçanta të muajve në version të folmes popullore (psh. për muajt e verës-djegaguri, ose për kohën e acarrit dimëror-ngrasi), të krahasueshëm me kalendarin babilonas ose egjiptian, sot i gëzohen kryesisht fëmijët, por pa e ditur historinë e as rëndësinë e tij. Një mrekulli, një pasuri të këtille të ruajtur deri në kohën tonë, doemos lypset ta faktorizojmë dhe ta dialogojmë e ta konsumojmë për promovimin e trashëgimisë kulturore dhe të funksionalizimit të saj për turizëm të kohës moderne.

Për festën e Shëngjergjit, që poashtu është pjesë e kalendarit popullor, zgjedhëm ta vizitojmë fshatin Mazrekaj të trevës së Hasit. Dëshiroam të vëzhgojmë në vigile të festës, prandaj 5 maji 2011 për Departamentin e Etnologjisë dhe Antropologjisë kulturore ishte ditë e hulumtimeve terrenistike. U nisëm që në orën 7 të mëngjesit, për t' u kthyer diku në mesnatë. Për studentët ishte sfidë dhe gëzim, i kaploi ndjenja se çfarë do të mësojnë kësaj radhe!

Të përmendi atraksionin e larjes rituale të fëmijëve për ditë Shëngjergji, me ujë ku ishin vendosur lule pemësh, gjethe e lule të tjera, hithëra dhe kungull të egër, pastaj ushqimin karakteristik festiv ritualistik, si bukë misri dhe pshesh me qumësht, shëtitje e vizita te fqinjët, luhajat te lisi i katundit, ndezje zjarresh e të tjera dhe të ndalem sërish në çështjen e veshjeve. Literatura na mëson se veshja e një shoqërie, si dhe domethënia e saj tregojnë edhe për dijen dhe për besimet që derivojnë nga e kaluara dhe që rimodelohen në të tanishmen. Si u komunikua dhe si e „lexuam“ këtë çështje në Mazrekaj?

Në kulturën shqiptare përgjithësisht për ditë festive, cila do qoftë kjo dhe veçmas për ditë Shëngjergji veshja zgjedhet të jetë plotësisht në funksion të plotësisht të atmosferës festive.

Kjo është më se e njohur. Por, për dallim nga fshtrat e Opojës, këtu në krahinë etnografike të Hasit veshja popullore, sikur ende ruhet e mbahet aktivisht, por jo nga të gjithë dhe jo në të gjitha rastet.

Mbahet vetëm nga disa nuse e gra të reja, nga ndonjë grua e moshuar dhe, për habi mbahet edhe nga vajzat e reja, të moshës madhore, jo në përditëshmëri, por në ditët festive. Po të analizohet struktura e një veshjeje, e një kostumi popullor që mbahet në rastet festive, pikërisht ajo që pamë më 5 maj 2011, duhet konstatuar se jo çdo veshje, qoftë kjo e meshkujve apo e femrave, i përgjigjet kriterëve të mirefillta etnologjike. Megjithatë, veshjet festive vet për vete kishin një bukuri, kishin morfologji, kishin ngjyra e ornamentikë dhe komunikonin simbolikë. Është për t' u theksuar se veshjet më të bukura për femra janë ato që i dedikohen statusit shoqëror e civil nuse dhe gra të reja, pra femra të martuara. Në kulturën popullore kontrolli shoqëror i mjedisit respektiv këtë çështje e rregullon saktësisht e në mënyrë rigorozë, ndërsa shmangiet i trajton si deformim dhe i sanksionon me përbuzje e përqeshje. Por, për çudi, në kohën e sotme, në raste festive këtë veshje e mban edhe vajza, edhe pse ajo si pozitë shoqërore e civile vendoset në femra të pamartuara. Madje vajza mban edhe dy mbështjellakët, që në traditën popullore i dedikohen ekskluzivisht statusit civil e shoqëror femër e martuar (!). Prandaj, ajo që vërejtëm në Mazrekaj na shpie në përfundim se bashkëkohësia dhe moderniteti nuk respekton kriteret e mirefillta të veshjes popullore, por thjesht pëlqen të bukuren dhe atraktivitetin. Po të shikohet aspekti i materialitetit të veshjeve që patëm rastin t' i shohim këtu, duhet theksuar se veshjet e meshkujve janë më uniforme dhe përveç zbatimit të spikut, shfaqen me fare pak dekor, sakaq veshja e femrave shfaqet shumë më e dekoruar, dhe më e modifikuar sipas dëshirës e shijes vetanake të bartëses. Në strukturën e veshjes për gra të reja, mbetet i pëlqyer fistani (fustani) me palë, që mbahe të qepura, dhe po t' i liroheshin palet nga qepja, sigurisht se do t' i përngjante fustanellës. Bartëset lavdëroheshin se fustanat e tyre kanë nga 30 fletë (kupto kinda), prandaj sajojnë shumë palë e gjërësi të madhe.

Këmisha e pjesës së epërme të trupit është e shkurtër, e ngjyrës së bardhë, madje edhe të tejdukshme, e materialit sintetik industrial, por e qepur dhe e prerë ngjashëm si këmisha e pëlhuarës së veku.

Për profesionistin shfaqet e vështirë të „lexohen“ ngjashmëritë e kësaj këmishë me linjen ose dalmatikën ilire që transmetohet në kulturën shqiptare, por bartëset e modernitetit nuk e kanë këtë preokupim. Mbi material të bardhë aplikohet qëndisja e ornamentimi i bollshëm, i cili përfitohet me penj e rruaza ngjyrash tejet disperzive. Ornamentet shfaqen të lashta që arrijnë në kulturën ilire, si fjala vjen me rreth ose rrathe koncentrik, pastaj me gjethe e me lis, me zig-zake; ose, me lule të ndryshme, thjesht si imitimi i rrethinës ku jeton bartësja. Nga ornamentet e reja dallohet motivi me zemër, që aplikohet kryesisht në „grykëzën“ e këmishës së grave dhe që jep efekte e porosi simbolike mjaft të lexueshme. Veshjet si tërësi, këto që i vëzhguam në festën e Shëngjergjit, përkundër shmangieve, megjithatë ofrojnë bukuri dhe zgjojnë emocione e atraktivitet. Tek e fundit funksioni i veshjes në rastet festive, realisht vjen për të krijuar imazhe të bukurisë, të artistikës, të simbolikës e kështu me radhë.

Në rastin e rritit për thirrjen e shiut (riti i dodolisë), të cilin studentët patën rastin ta përcjellin në Romajë të Hasit, u tregua se për pelegrinët-thënë simbolikisht, veshja zgjedhet më e mira, më e reja si në çdo ditë të shënuar, festive, por personi-vajza që luan rolin e dodolisë, mbi një veshje fare të thjeshtë mbulohet e tëra me rrema e gjethe të njoma. Veshja e të tjerëve shfaqet e ngjashme si ajo në Mazrekaj, meqë bëhet fjalë për krahinë të njëjtë etnografike. Në parakalim nëpër fshat këtë dodoli, kohëpas-kohë e spërkasim me ujë gratë që dalin nga shtëpitë e veta, por edhe dhurojnë ushqime pëer pelegrinët. Njerëzit shkojnë, ecin pas dodolisë, bëjnë zhurmë e rrahin gjësende të metalta që krijojnë zhurmë, tingëllima e të ngjashme dhe kohë pas kohe i thërrasin dodolisë dhe shiut. Kur krahasojmë shpjegimet shkencore dhe këtë rit të kulturës tonë, mësojmë se veshja dhe veprimet e njerëzve, shpërfaqin një religjion të lashtë zanafillor popullor, të sforcuar me të bëma e magji imitative homeopate, që për qëllim kanë mëshirimin e perëndisë për të dhënë shi. Janë këto rite e veprime të njohura edhe për kultura të tjera botërore, ndërsa për ne është e rëndësishme që ritet e këtilla kujtohen në popull, dhe improvizohen me atraktivitet e me sukses.



RITI I VERZËS

13-14 Mars, 2011
Bresanë, Opojë

Cak, cak u bëfsha
Sa lisi i gjatë



Foto Drita Halimi- Statovci

Cila vajzë e ka shportën më të bukur dhe më shumë vezë të ziera



Foto Arbenita Bajraliu

Gara zjarresh
Zjarri im i pari
Zjarri im më i madhi



Foto Arbenita Bajraliu

Studentët e Etnologjisë dhe Antropologjisë Kulturore
midis datave 13-14 Mars vigjilje dhe Ditën e Verzës



Foto Rozafa Berisha

Kapërcimi i zjarrit si spastrim- purifikim



Foto Arjona Caraku

Pamje nga nderzja e zjarrit në një nga lagjet e Bresanës



Foto Drita Halimi - Statovci

Në fshatin Zhur- shëti në vigjilen e ditës së Verzës



Foto Faton Zeka

Shëtitje nëpër Bresanë me këngë



Foto Zanita Halimi

Gëzim- Këngë e valle rreth zjarrit



Foto Blerta Krasniqi

Dëshira për ndezjen e zjarreve sa më të larta



Foto Blerta Krasniqi

Flaka e zjarrit në mitologji shpjegohet si dhënie fuqi diellit



Foto Drita Halimi- Statovci

Vezën e drunjte nuk mund ta thyej askush

RITI I SHËNGJERGJIT

5-6 Maj, 2011
Mazrekaj, Has

Sallanxhak, sigjimi
Këtu e te xhamia
Ani çaq mu bëfshin
Flokët e mia



Foto Zanita Halimi

Muzikë me Borozoga punuar nga lëvorja e frashërit



Foto Simon Berisha

Studentët e Departamentit të Etnologjisë dhe Antropologjisë Kulturore
duke zbatuar metodën e vëzhgimit në terren



Foto Faton Maliqi

Kulti i Bimësisë në funksion të shëndetit në Blegtori



Foto Faton Maliqi

Kulti i bimësisë në funksion të dekorit,
të thirrjes së mirëqenies për familje dhe shtëpi



Foto Blerta Krasniqi

Pasqyrim për kultin e bimësisë në ditën e Shëngjergjit



Foto Blerta Krasniqi

Funskioni ceremonial i ushqimit si begati për vit të mbare



Foto Blerta Krasniqi

Riti i larjes ritual dhe reflektimi i kultit të bimësisë dhe i ujit



Foto Blerta Krasniqi

Sallanxhak , sigjimi
Këtu e te xhamia
Ani çaq mu bëfshin
Flokët e mia



Foto Drita Halimi- Statovci

Muzikë me pipëza bimësh



Foto Drita Halimi- Statovci

Përgatitja e barishteve për ushqimin e bagëtisë në Ditën e Shëngjergjit



Foto Drita Halimi- Statovci

Për Shëngjergj edhe vajzat bënë të vishen si nuset



Foto Drita Halimi- Statovci

Sitja e miellit për bukën rituale

RITI I THIRRJES SË SHIUT

Romajë/Has

Dordolec, Dordolec
Lutju zotit t'na bjerr shi
le t'na mushet kosh i ri
le t'na mushet me bereqet
ta kalojmë vitin me shnet



Foto Simon Berisha

Sinkronizimi i ritit të thirrjes së shiut dhe vargjeve

Oj e zoja shpisë

Fali dodolisë

le t'na mushet kosh i ri

le t'na mushet me bereqet

ta kalojmë vitin me shnet



Foto Faton Maliqi

Veshja më e mirë rezervohet në raste ritual



Foto Faton Zeka

Edhe burrat kontribojnë për bukën rituale



Foto Blerta Krasniqi

Të mbledhur së bashku gjatë ritualit të thirrjes së shiut



Foto Zanita Halimi

Buka rituale



Foto Blerta Krasniqi

Breshka në funksion të thirrjes së shiut



Foto Faton Maliqi

Kolona e bashkëfshatarëve pas dodolisë



Foto Blerta Krasniqi

Rregullimi i dodolisë me rrema e gjethe në funksion të thirrjes së shiut

It happens quite often to us to make some act, weather as custom, or simply as a special practice, without knowing well their meanings, and even less their historic and their relation to the past. Among special occasions filled with different practices are annual rites, consisting relevant part of cultural heritage. As cultural phenomena rites contain various social actions and practices, each of them bearing their own meaning and purpose aiming to reach the effect in the benefit of humans.

Department of Ethnology and Cultural Anthropology in cooperation with the Organization of Young Ethnologists and with the support of the Cultural Heritage Organization Without Borders has realized the project Rites and Contemporariness /Present Time, aiming the research, registration and presentation of the annual rites. Students of the Department of Ethnology and Cultural Anthropology had opportunity, besides theoretical knowledge, to do research and attend directly in the fieldwork three rites: Rite of Verza (Small Summer), Rite of Shëngjergji (Saint George) and Rite of Calling the Rain.

During the fieldwork were given explanations of the meanings for each social action and practice, made during the rite process, then there were shootings and broadcasting in central and local televisions. Shooting of these rituals will help not only future generations to better know the past, and learn about relevance of the rituals and heritage richness of spiritual and material culture, but will also serve as study material for different scholars, not only those of Ethnology and Cultural Anthropology.

During the fieldwork numerous pictures were taken by the students of the Department of Ethnology and Cultural Anthropology themselves, and some of them are presented in this Catalog, with texts offering their respective description and explanation. In this catalog through short writings of the Department of Ethnology and Cultural Anthropology Professors, respectively Prof. dr. Ukë Xhemaj with the topic "Annual Rites/Ritet e motmotit", and of Prof. dr. Drita Halimi Statovci, with the topic "Costumes in the function of rites", readers will have opportunity to get informed more regarding the relevance of these rites as part of cultural heritage, as well as for the survivals of ritual elements to the present time.

Cooperation always does a better job and gives substantial realizations. In this case, special thanks go to the Cultural Heritage Without Borders Organization, for their given support to this project, to the professors and students of the Department of Ethnology and Cultural Anthropology, to the Association of Young Ethnologists, to the inhabitants of village Bresanë in Opojë, of the villages Mazrekaj and Romajë in Has, for their readiness and frankness towards our research, and especially for their warm hospitality. Particularly we thank Televisions RTV21 and KTV for their contribution given to shootings of rites and direct researching in the fieldwork, as well as the broadcasting of the emissions regarding these activities.

This catalog contributes to preserving the past, so it can serve to the present and to the future.

Annual Rites/Customs

Annual rites in Albanian culture present a treasure of values, which in their content preserve surviving of numerous beliefs, superstitions, magic deeds of homeopathic and purifying character or that of fertility – always aiming a well being and the service to an individual, group or broader social circle. Rites are a gestation of the way of human living in natural environment reflecting worthily relations: human-nature. These relations express life meaningfulness as an expression of actions, conditionally tied to natural phenomena – directly as an opportunity of living in geographical environment. These cultural values coordinated in annual ritual ceremonies, in Albanian cultural tradition and, especially in remoter ethnographical zones such as Opoja and Hasi, are encountered layered. Their uncovering delineate from present time to the obscured historical ancient times, respectively to the earliest modes of life organization, beliefs, customs, way of housing, clothing, working tools etc.

Distinctive cultural value of these rites is massiveness of the pilgrims in the ritual ceremony; social, gender and age structure of pilgrims; cultic dedication; application of annual working calendar leaning on sun eclipses; survived belief in natural phenomena; their lineation to present times.

Anthropological literature discusses rites and rituals as events involving peculiar social works, practiced in certain times, such as for example in marked dates and feast-days, or significant for the benefit of human well being. Divergence or deviation from quotidian behavior appears as characteristic feature regarding rituals. Deviations, as would be said symbolically, emerge from normality in different nature and they could be of material character, or simply emerge as a human or social behavior. Furthermore, it should be noted that rituals can be of sacral or secular nature, or of the nature composed of both these segments, and, finally of simply genuine popular-pagan religious nature. Costumes appear to be of great relevance and seize symbolic and communicative place in ritualistic events. We will now be introduced regarding this segment of material culture as a phenomenon related to rituals, as a part of spiritual and social culture. Anthropological studies emphasize that costume of a society, as well as their meaning show a lot regarding the knowledge and beliefs deriving from the past and which are remodeled in the present.

In Albanian culture, generally, during the fiesta-days, whichever it is, costume will be selected in order to completely be in the function of fulfilling festive atmosphere. In some ethnographical zones folk costume is almost outdone completely, whilst in some others, such in Has, these clothing is still preserved and even actively carried, but not by everyone and not in every occasion. It is carried by some brides and young women, by any old woman and, surprisingly it is carried even by young girls, of adolescent age, not every day, but in feast-days. If a structure of clothing, of a folk costume carried in a feast event is to be analyzed, exactly the one we have observed on May 5th 2011, we should ascertain that not every clothing, weather male or female, is adjusting to the genuine ethnological criteria. However, festive clothing itself had a beauty, had morphology, had colors and ornaments and they communicated symbolic. It is worth noting that most beautiful women's costumes are those dedicated to the social and civic status of bride and young women, thus married women. The culture of respective environment regulates the issue of how to carry folk costumes precisely and rigorously, while deviances are considered as deformation and are sanctioned scornfully and with mocking. However, in present times, in festive events bride's costume is carried also by girls, even though according to her social and civic status she belongs to unmarried women. Such deviations from the originality of the tradition lead to the conclusion that contemporariness and modernity do not respect genuine criteria of folk costumes, but it is simply liked as a beautiful, as attractive and spectacular.

IMPLEMENTUAR NGA:

DEPARTAMENTI I ETNOLOGJISË DHE
ANTROPOLOGJISË KULTURORE



Organizata e
Etnologëve të Rinjë

PËRKRAHUR NGA:

CH
WB

Cultural
Heritage without Borders
KULTURARY UTAN GRÄNSER